

*Prandaj kështu thotë Zoti,
Perëndia i ushtrive, Perëndia
i Izraelit: Ja, unë po bëj që
të vijë mbi Judë dhe mbi
gjithë banorët e Jeruzalemit,
gjithë atë të keqe që kam
shqiptuar kundër tyre, sepse
u kam folur, por nuk më
kanë dëgjuar, i kam thirrur,
por nuk më janë përgjigjur".*

Jeremja 35:17

*Por ai u tha: "Me tepër lum
ata që e dëgjojnë fjalën e
Perëndisë dhe e zbatojnë."*

Luka 11:28

Koha e qetë me Perëndinë

nga Blerta Myrteza



Çfarë është koha e qetë?

Koha e qetë është një kohë e caktuar e përditshme, kur një i krishterë takohet vetëm për vetëm me Zotin në lutje, adhurim dhe lexim të Biblës.

Sa e rëndësishme është koha e qetë?

Koha e qetë është e domosdoshme për njohjen personale të Perëndisë dhe për rritjen tonë. Besimi i krishterë është marrëdhëniet me Perëndinë e gjallë dhe çdo marrë-

dhënie ndërtohet mbi komunikimin e dyanshëm. Pa komunikim të mirë e të mjaftueshëm, çdo marrëdhënie është e destinuar të degradojë.

Në kohën e qetë ne i flasim Perëndisë në lutje dhe Ai na flet në Fjalën e Tij. Në fakt tek Gjoni 17:3, Zoti Jezus thotë, "Dhe kjo ështëjeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar."

Në fillimet e besimit tim drejtuesja e studimit tim biblik na mësoi të kishim kohën tonë të qetë të përditshme me Zotin, dhe ajo ka qenë një faktor kyç në rritjen time në besim.

Koha e përditshme në leximin e Biblës na lejon ta njohim Perëndinë

çdo ditë e më thellë, të njohim karakterin e Tij, rrugët e Tij, vullnetin e Tij për ne, premtimet e Tij të çmuara, dashurinë e Tij të pafund dhe shenjtërinë e Tij. Në lutje ne mund t'i shprehim Perëndisë shqetësimet dhe kërkesat tona, lavdërimet dhe adhurimin tonë.

Në Psalmin 119:102 psalmisti thotë, "Nuk jam larguar nga dekretet e tua, sepse Ti Vetë më ke mësuar." E pra, koha e qetë është koha kur Perëndia na mëson Vetë.

Çfarë përban koha e qetë?

Mund të ketë mënyra të ndryshme të organizimit të kohës së qetë me Perëndinë, por ajo normalisht duhet të përbajë **lexim** të

Hendricks dhe William Hendricks.

E para: është e rëndësishme ta lexosh Biblën nga fillimi dhe me rradhë. Nëse do të fillosh nga mesi, nuk do të dish cilët janë personazhet e përmendorur, sepse ata janë qartësuar në librat më të hershëm.

E dyta: E mira është që nëse po e lexon Biblën për herë të parë, të lexosh **më shumë dhe më shpejt** për të kapur tablonë e madhe. Por, sado pak apo shumë të lexosh, është e rëndësishme që ajo pjesë që lexon të jetë **një paragraf**, pra të përbajë një mendim, një mësim apo ngjarje **të plotë**. Në Biblat tona kemi ndarje të tillë në paragrafë që paraprihen nga tituj me shkronja të zeza, gjë që na e bën punën më të lehtë. Kije vëmendjen për paragrafat, dhe pastaj mund të lexosh një, dy ose më shumë të tillë.

E treta: Ngjarjet e përshkruara në Biblë kanë ndodhur në kohë dhe hapësirë. Kije vëmendjen për treguesit kohorë dhe vendorë në tekston. Gjithashtu, përdor një

Bibël që ka harta në fund, ose merr një atlas biblik. Ki mendjen edhe për personazhet.

E katërta: disa nga Biblat kanë një fjalorth në fund që qartëson shumë terma. Është e mira ta gjeni një të tillë.

E pesta: përdor lapsa me ngjyra për të shënuar disa gjëra: 1) *treguesit kohorë*, p.sh. me jeshile, *vendet* me portokalli, *personazhet* me blu, ndonjë *varg kyç* me të verdhë, etj.

E gjashta: dallo çfarë lloj letërsie është ajo që po lexon.

Bibla ka disa lloje letërsish. Ka tregim, ose histori, ka poezi, ligj, apokalips, profeci, shembelltyra dhe letra. Secila nga ato ka parime të veçanta të interpretimit. Për më shumë referojuni librit që përmenda më sipër.

Një pyetje shumë e rëndësishme gjithmonë është: "Cili është **konteksti** apo sfondi rrethues i këtyre fjalëve, apo i kësaj ngjarjeje? Në çfarë konteksti ndodhi kjo ngjarje ose u thanë këto fjalë?"

Pastaj, pasi të mbarosh pjesën e leximit, bëji vetes disa pyetje: Cila ishte përbajtja me pak fjalë? Cili është kuptimi? Si lidhet kjo me ato që kanë ndodhur më parë? Po me premtimet për të ardhmen?

Por ti mund të thuash: "Disa gjëra nuk i kuptoj dhe kjo më dekurajon." Te **Ligji i Përtërirë 29:29** thuhet: "Gjërat e fshehta i përkasin Zotit, Perëndisë tonë, por gjërat e shfaqura janë për ne dhe për bijtë tanë për gjithnjë, me qëllim që të zbatojmë në praktikë tërë fjalët e këtij ligji."

Ndoshta do të ketë gjithmonë disa gjëra në Biblë që nuk do t'i kuptojmë. Ndoshta do të ketë pyetje që do mbeten tani për tani pa përgjigje. Nuk ka asgjë të çuditshme këtu. Ne nuk mund të kuptojmë gjithçka dhe Zoti disa gjëra nuk na i ka zbuluar. **Por ato që na i ka zbuluar, na i ka zbuluar që t'i zbatojmë.**

Prandaj në fund duhet të bëjmë pyetjen: **Çfarë duhet të bëj unë tani?**

A ka ndonjë mëkat që duhet ta rrëfej dhe braktis?

A ka ndonjë premtim që duhet ta besoj?

A ka ndonjë urdhërim të drejt-përdrejtë që duhet ta zbatoj?


A ka ndonjë shembull që duhet ta ndjek?

Dhe pastaj të **veprojmë** sipas rastit. Nëse e lëmë pas dore këtë hap të fundit, koha jonë e qetë do të ketë qenë e kotë. Kur Zoti flet, ne duhet të përgjigjemi, duhet të reagojmë, dhe ka dy mënyra si mund të reagojmë: me besim dhe bindje ose me mosbesim dhe mosbindje.

Dhe ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes zbatimit dhe kuptimit. Nëse jemi të zellshëm për të zbatuar ato që kuptojmë, do të na jepet të kuptojmë edhe më shumë.

Te Gjoni 14:21 Zoti Jezus thotë: "Kush ka urdhërimet e mia dhe i zbaton, është ai që më do; dhe kush më do mua, Ati im do ta dojë; dhe unë do ta dua dhe do t'i dëftehem atij."

Zoti ju bekoftë ndërsa kaloni kohë qdo ditë me Të!



Libri i udhëzimeve të Perëndisë

Shokët e tu janë si butonat e ashensorit. Ata ose do të të ngrenë lart ose do të të çojnë poshtë (Fjalët e Urta 13:20).

Karakteri i vërtetë i një personi zbulohet në bazë të asaj që bën kur nuk e shikon askush (Efesianëve 6:6).

Më mirë të vdesësh me një emër të mirë, sesa të jetosh me një emër të keq (Predikuesi 7:1).

Disa njerëz ankohen pse Perëndia vendos gjemba te trëndafilat, ndërsa të tjerët e lavdërojnë Atë që ka vendosur trëndafila midis gjembave (Filipianëve 4:8).

Masa e një burri nuk matet se sa i madh është besimi i tij, por sa e madhe është dashuria e tij (1 Korintasve 13:13).

Është e mirë të jesh i krishterë dhe ta dish, por është më mirë të jesh i krishterë dhe ta tregosh (Gjoni 13:35).

Brengë shikon pas. Shqetësimi shikon vërdallë. Besimi shikon lart (Hebrenje 12:2).

Suksesi në martesë është më tepër sesa të gjesh personin e duhur. Do të thotë të bëhesh personi i duhur (1 Timoteut 6:11).

Nëse ke filluar një detyrë, mos e lër derisa ta kryesh. Qoftë punë e madhe apo e vogël, bëje mirë ose mos e nis fare (Gjoni 17:4).

Koha është më e vlefshme se paraja, sepse koha është e pazëvendësueshme (Efesianëve 5:16).

Mënyra më e mirë për të harruar problemet e tua është të ndihmosh dikë që të zgjidhë të tijat (Filipianëve 2:4).

Shqetësohu më tepër për atë që mendon Perëndia për ty, sesa për atë që mendojnë njerëzit për ty (Veprat e Apostujve 5:29).

Mënyra më e mirë për të thënë fjalën e fundit është të kërkosh falje (Fjalët e Urta 6:2,3).

Asnjë njeri nuk zbulon me të vërtetë se çfarë beson, derisa të fillojë të mësojë fëmijët e tij (Efesianëve 6:4).

Mos e ngatërrro aktivitetin me arritjen. Të jesh i zënë nuk do të thotë të jesh produktiv (Luka 10:40-42).

Kënaqësia nuk është të marrësh atë që do, po të jesh i kënaqur me atë që ke (Filipianëve 4:11).

Nuk mund t'i marrësh paratë me vete, por mund t'i dërgosh para se të mbërrish atje (Mateu 6:19, 20).

Zotësia do të mundësojë një person të dalë në krye, por karakteri do ta mbajë atë atje (Fjalët e Urta 11:5).

Fjalët e tua janë dritare për zemrën tende (Mateu 12:34b).

Jezusi është një mik që i njeh të gjitha gabimet e tua dhe megjithatë të do (Romakëve 5:8).

Mund të fitosh më tepër miq me veshët e tu, sesa më gojën tende (Jakobi 1:19b).

Emri i mirë fitohet për një çast, por karakteri ndërtohet për tërë jetën (Jobi 27:6).

Ai që gropos talentin e tij bën një gabim të rëndë (1 Timoteut 4:14a).

Jetesa do të ishte më e lehtë nëse burrat do të kushtonin po aq vëmendje në shtëpi sa edhe kur peshkojnë (1 Pjetrit 3:7b).

Të falësh do të thotë të çlirosh një të burgosur dhe të zbulosh që ai i burgosur je TI (Mateu 6:14, 15).

Shoqëria që ke do të përcaktojë problemet që do të hasësh (Fjalët e Urta 22:24, 25).

Trashëgimia më e mirë që një baba mund t'u lërë fëmijëve të tij është një shembull i mirë (1 Thesalonikasve 2:11).



Këshillimi biblik lulëzon në Tokën e Shqiponjave

Çfarë është këshillimi biblik?

Në vitin 1656, puritani Riçard Bakster shkroi se vetë Shkrimi është i dobishëm për të krishterët “për t’iu hequr dyshimet, për t’i ndihmuar në luftën kundër mëkateve të tyre, për t’i drejtar në detyrën e tyre dhe përritje të njohurisë dhe të gjithë hirit shpëtues”.¹ Ndryshe nga psikologjia, e cila ka një pikëpamje për jetën që është e përqendruar te njeriu dhe e kundërshton konceptin e ‘mëkatit’, këshillimi biblik bazohet në bindjen se Perëndia na ka folur përmes Shkrimit. Përmes Biblës, Perëndia na ka zbuluar gjithçka që duhet të dimë për Të, përveten tonë dhe përbotën përreth nesh (2 Pjetrit 1:3).

¹ Richard Baxter, *The Reformed Pastor*, reprinted (New York: Robert Carter & Brothers, 1860), p. 346

Këshillimi biblik, i cili disa herë është quajtur "një hibrid mes dishepullimit dhe miqësisë biblike", ka përfitimin shtesë të përgjegjshmërisë. Kur një i krishterë kërkon ndihmë nga një këshillues biblik i trajnuar pér një problem shpirtëror të vazhdueshëm, ai apo ajo do të duhet të bëjë detyra shtëpie, të mësojë përmendësh disa pasazhe nga Shkrimi dhe të bëjë punën e vështirë të ndryshimit biblik ndërmjet sesioneve. Të mësosh ta kuqtoшt drejt Fjalën e Perëndisë dhe të ndihmosh njerëzit ta zbatojnë atë në jetën e tyre nuk është ide e re, por këshillimi biblik është rritur shumë në Shqipëri këto vitet e fundit.

Nga Bashkësia e Hirit, me dashuri

Në vitin 2007, Kisha e Bashkësisë se Hirit (Grace Fellowship Church) në Kentucky, SHBA, dërgoi Bler dhe Suana (Blair dhe Sue Ann) Alvidrez në Shqipëri në një udhëtim misionar afatshkurtër. Pasi u vendosën në Lushnjë në vitin 2010, Bleri dhe Suana u bënë të parët këshillues biblikë në Shqipëri. Brenda pak viteve, Bleri po organizonte konferanca trainimi pér shqiptarë që donin të mësonin si të këshillonin në kishat e tyre lokale. Pastorë amerikanë nga Shoqëria e Këshilluesve Biblikë të Certifikuar (Association of Certified Biblical Counselors) erdhën në Tiranë pér të ndihmuar me trajnimin. Bashkë me Pastor Genci Cesulën, pastor kryesor



në Kishën e Hirit në Tiranë dhe pastorë dhe misionarë të tjerë, Bleri themeloi *Koalicionin e Këshillimit Biblik Shqiptar*.

"Këshillimi biblik po fiton mjaft popullaritet", thotë Bleri. Ai dhe familja e tij kanë jetuar në Tiranë pér disa vjet, ku ai punon bashkë me Genci Cesulën, duke dishepulluar dhe trajnuar pastorë të tjerë që synojnë certifikimin. "Shumë njerëz thanë në fillim, 'Kjo nuk do të funksionojë këtu'", thotë ai. Më shumë se në Amerikë, në Shqipëri njerëzit e kanë të vështirë të flasin lirshëm pér problemet e tyre. Megjithëse betejat shpirtërore me të cilat përballen besimtarët janë të ngjashme në të gjithë botën, shqiptarët e kanë më të vështirë të kërkojnë këshillë. Kjo është pjesërisht pér shkak të një mosbesimi të përgjithshëm ndaj autoritetit dhe një shqetësimi të përgjithshëm në lidhje me thashethemet. Megjithatë, me këmbëngulje dhe trajnim të vazhdueshëm, shumë njerëz tanë po kërkojnë këshillim brenda kishave të tyre lokale. Disa pastorë shqiptarë i kanë përfunduar provimet e tyre të certifikimit dhe po këshillojnë tashmë, dhe disa nga gratë e tyre po ndihmojnë duke këshilluar gra dhe duke përkthyer libra.

Fryti i shërbesës së përkthimit

Deri tanë janë përkthyer në shqip 23 tituj në lidhje me këshillimin biblik, duke përfshirë këtu librin e Pol Trip, "Instrumente në duart e Shpenguesit", një numër jo i vogël, sidomos kur e krahason me vendet fqinje ku teologja e Reformuar dhe këshillimi biblik janë pothuaj të panjohur. Bashkësia e Hirit, kisha dërguese e Blerit dhe Suanës në Amerikë ka siguruar financa dhe njerëz pér të ndihmuar; megjithatë, këshillimi biblik **nuk** është shpikje amerikane. Apostulli Pal, në letrat e tij, na jep modelin e parë të një këshilluesi i cili është vërtet biblik. Ai përdor Fjalën e Perëndisë pér të mësuar besimtarët e rinj, pér të inkurajuar kishat e përndjekura, pér të bindur pér mëkat

besimtarët dhe pér të pajisur ata që ishin në shërbesë. Pasi Bibla vetë u përkthye në gjuhë të tjera, Ungjilli u përhap në më shumë popuj sesa do të kishin arritur misionarët me mësimet gojore. Në mënyrë të ngjashme, parimet e këshillimit biblik mësohen kryesisht përmes konferencave, por koncepti prezantohet edhe më gjërisht përmes literaturës.

Disa herë shërbesa e Fjalës duket se ndodh vetvetiu. Bleri tregon një incident kur makina e tij kishte nevojë pér lavazh. Ai kishte qindra librushka të përkthyera në ndjenjësen e pasme të makinës, në kuti që po shqyheshin. Ai me kujdes i vendosi ato në trotuar ndërsa kishte lënë makinën në lavazh dhe dy burra shqiptarë treguan shumë interes në atë literaturë. "Çfarë janë këto? A mund t'i shikojmë?". Bleri u shpjegoi me gëzim që ato ishin librushka që flisin pér Perëndinë dhe se si të jetosh në mënyrë që t'i pëlqesh Atij. "A mund të blejmë disa?", pyetën burrat.

Lajmi është përhapur në vendet fqinje të Ballkanit në lidhje me këtë këndvështrim "vetëm Shkrimi" të këshillimit të krishterë. "Ne tani kemi kontakte në Maqedoni", thotë Bleri. Disa pastorë nga Shkupi morën pjesë në trajnimin e kohëve të fundit në Kishën e Hirit, dhe një kishë në Kosovë, që e ka mbushur librarinë e saj me materiale këshillimi, ka treguar interes pér të dérguar përfaqësues.

Nga qumështi te mishi... progresioni i trajnimit

Deri tanë janë mbajtur katër konferanca vjetore pér trajnim në këshillimin biblik, të mbajtura në Durrës, Tiranë dhe Korçë. Bleri dhe pastorë të tjerë që kanë dhënë mësim atje, janë inkurajuar nga rritja që kanë parë në besimtarët që marrin pjesë. Tani, më shumë pastorë lokalë po e marrin trajnimin vetë në seminare një herë në dy muaj që quhen "module trajnimi." Ato fokusohen në tema më specifike këshillimi si martesa, depresioni dhe problemet e kombinimit të psikologjisë me Biblën. Bleri thotë që



ky trajnim i specializuar është efektiv dhe i ndihmon pastorët të mësojnë si t'u shërbejnë besimtarëve me Fjalën brenda kontekstit të kulturës së tyre. "Ne japim një rast studimor në çdo sesion dhe pjesëmarrësit diskutojnë se çfarë do të bënin", shpjegon ai. "Është shumë e mrekullueshme të shohësh se si pjesëmarrësit po e përvetësojnë mësimin dhe se si procesi po hedh rrënje".

Ndikimi i këshillimit biblik po fillon të njihet edhe përtej mureve të kishës lokale, ndërsa Bleri, Suana dhe Koalicioni i Këshillimit kanë krijuar marrëdhënie me shkolla dhe klinika mjekësore. Klinika e krishterë ABC në Tiranë ka dërguar punonjës për të dëgjuar leksionet mbi ankthin dhe depresionin dhe u kanë kërkuar Blerit dhe pastor Genci Cesulës t'u dërgojnë këshillues biblikë.

Tabloja e madhe – kisha si pjesë e jetës

Ashtu si çdo kulturë post-moderne, edhe Shqipëria po përballet me problemet e saj që shumë njerëz thonë që nuk kanë rrjedhoja shpirtërore. Pastor Cesula rreshton depresionin dhe problemet marte-sore midis çështjeve më të mëdha të këshillimit, por gjithashtu përfshin edhe pornografinë në atë listë. Imoraliteti seksual (veçanërisht

pornografia) po bëhet shumë më i dukshëm sesa në vitet e shkuara, dhe pa një themel biblik, moraliteti konsiderohet subjektiv. Një nga synimet e dishepullimit dhe të këshillës vërtet biblike, është ta sjellësh ungjillin në të gjitha fushat e jetës së personit. Burrat dhe gratë e përfshira në shërbesën e këshillimit biblik përpilen të komunikojnë që 'kisha' nuk është ndërtesë, por një trup dinamik besimtarësh të lidhur me njëri-tjetrin që ndihmojnë njëri-tjetrin të rriten. 'Këshilla biblike' nuk është thjesht të japësh përgjigje apo të citosh vargje; ajo kërkon që Kisha të veprojë ashtu siç e projektoj Perëndia – si një institucion dishepullbërës. "Është ngazëlluese të shohësh se si Perëndia po ngritet nga e gjithë bota që janë të uritur për të mësuar përgjigjet biblike për jetën e tyre, dhe inkurajuese të shohësh përkushtimin e popullit të Tij kudo", tha një pastor.

Shqipëria, e bukura "Tokë e Shqiponjave", po përtërihet në forcë. Në Shkrimet, shqiponja është simbol i forcës dhe i aftësisë për të mbajtur shumë peshë (Eks. 19:4; LiP. 32:11). Në të njëjtën mënyrë metaforike, Shqipëria është ngritur brenda një brezi nga shtypja e ateizmit në një vend me një nga mëdha të fortë të krishtera në Ballkan. Falë punës së palodhur të një brezi të ri pastorësh

dhe këshilluesh biblikë, ajo në mënyrë të sigurt po "ngrihet me krahë si shqiponja" ndërsa besimtarët e rinj e bëjnë të njobur Emrin e Tij.




Nga
Marie Notcheva

Mari Noçeva (Marie Notcheva) është shkrimitare dhe këshilluese biblike e certifikuar nga INS nga Masaçusetsi. Libri i saj i parë, "*Redeemed from the Pit: Biblical Repentance and Restoration from the Bondage of Eating Disorders*" (Calvary Press, 2011) ("*Shpenguar nga gropat pendim dhe restaurim biblik nga skllavëria e çrrëgullimeve të të ngrënët*") është libër reference për këshilluesit që punojnë me njerëz me probleme anoreksike dhe bulimike. Maria është kontribuese e rregullt e blogut të Koalicionit të Këshillimit Biblik (The Biblical Counseling Coalition blog), dhe shkruan për revista të krishtera në Shqipëri dhe Bullgari. Ajo punon si përkthyese me kohë të plotë e bullgarishtes në Boston dhe ka katër fëmijë.



Para se të kishin lindur malet dhe para se
ti të kishe formuar tokën dhe botën, madje
nga mot dhe përjetë ti je Perëndia.

Psalm 90:2

A young girl with blonde hair, wearing a yellow patterned headband, a white short-sleeved shirt, and a green and yellow checkered skirt, is sitting on a weathered wooden post. She is looking down at a single yellow apple she is holding in her right hand. The background is filled with bright sunlight and green foliage.

Mësoji fëmijës rrugën
që duhet të ndjekë dhe ai
nuk do të largohet prej
saj edhe kur të plaket.

Fjalët e Urta 22:6



*Mësoji fëmijës
rrugën që duhet
të ndjekë dhe ai
nuk do të largohet
nga ajo edhe kur të
plaket.*

(Fjalët e Urta 22:6)

Pir
Perëndinë
edo Zi
është e
mundur



MATEU 19:26 b



*Frika e Zotit është fillimi
i diturisë, dhe njohja e të
Shenjit është zgjuarsia.*

FJALËT E URTA 9:10

"A nuk tē urdhërova unë?
Ji i forte dhe trim; mos ki
frikë dhe mos u thyej, sepse
Zoti, Perëndia yt, është me
ty kudo që tē shkosh".

Jozueu 1:9



90

Sepse unë i ujoh
mendimet që kam
për ju," thotë Zoti,
"mendime pageje dhe
jo të së keqes, për t'ju
dhënë një të ardhme
dhe një shpresë.

Jeremias 29:11

Ata nuk do të
kenë më uri, as
nuk do të kenë
etje, as nuk do t'i
godasë më dielli,
as kurrfarë vape,
sepse Qengji,
që është në mes
të fronit, do t'i
kullosë dhe do t'i
çojë te burimet e
gjalla të ujërave;
dhe Perëndia do
të thajë çdo lot
nga sytë e tyre.”

Zbulesa 7:16-17



Çfarë është saktësisht Trinia?

Si mund të jetë Zoti tre persona në një? Cilit prej tyre duhet t'i lutem? Dhe çfarë roli luan secili prej të treve?

Koncepti i Trinisë është një nga misteret më të mëdha të Biblës. Ati është Perëndi, Biri është Perëndi dhe Shpirti i Shenjtë është Perëndi, por ekziston vetëm një Perëndi. Kjo është doktrina biblike e Trinisë.

Ndër vite janë bërë shumë përpjekje për të krijuar ilustrime të Trinisë, por asnjë prej tyre nuk ishte i përshtatshëm apo i saktë. Ilustrimi i vezës (ose mollës) bie poshtë, sepse guacka, e bardha dhe e verdha janë pjesë të vezës, jo veza vetë, dhe në të njëjtën mënyrë lëkura, tuli dhe farat e mollës janë vetëm pjesë të saj dhe jo vetë molla. Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë nuk janë pjesë të Perëndisë; Secili prej tyre është Perëndi. Ilustrimi i ujit bie poshtë pa mundur ta përshkruajë Trininë në mënyrë të saktë. Gjendja e lëngshme, avulli dhe akulli janë forma të ujit. Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë nuk janë forma të Perëndisë, secili prej tyre është Perëndi. Kështu, tabloja që përpilen të na japin këto ilustrime nuk është e saktë. Një Perëndi i pakufizuar nuk mund të përshkuhet plotësisht përmes një ilustrimi të kufizuar. Karakteri i Perëndisë është kaq i pamasë saqë ne, me mendjet tonë të kufizuara, nuk mund të kuptojmë gjithçka që Ai është. Romakëve 11:34 thotë: "Sepse kush e njohu mendjen e Zotit?"


Kujt i luteni ju?

Perëndisë Atë. Te Mateu 6:6 Jezusi thotë: "Por ti, kur lutesh...lutju Atit tënd në fshehtësi;" Pastaj Jezusi vazhdon duke na treguar si të lutemi, duke filluar me fjalët: "Ati ynë që je në qiej..."

Cilët janë rolet e tre personave të Trinisë?

Më poshtë është një këndvështrim i shpejtë, megjithëse jo i plotë:

Roli i Perëndisë Atë është të krijojë gjérat. Gjithçka fillon te Ai dhe vazhdon me Të. Perëndia është i barabartë me Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, por gjérat fillojnë me Të. Ati dërgoi edhe Birin (Gjoni 3:16-17) edhe Shpirtin e Shenjtë (Gjoni 14:26) në botë.



Roli i Birit është të paguajë për mëkatet tonë me anë të gjakut të Tij, gjë që e kreu duke vdekur në kryq (Romakëve 5:9). Biri gjithashtu luan rolin e avokatit tonë përparrë Zotit, duke u sjellë si një "ndërmjetës" mes nesh dhe Perëndisë (1 Timoteut 2:5), duke i folur në mbrojtjen tonë "...kemi një avokat te Ati..." (1 Gjonit 2:1).

Perëndia Shpirt i Shenjtë ka shumë role: Shpirti i Shenjtë na ndihmon të lutemi (Romakëve 8:26-27). Ai na jep jetë të re (Gjoni 3:3-6). Ai është Ngushëlluesi ynë dhe na ndihmon të kuptojmë Fjalën e Zotit (Gjoni 14:26). Ai dëshmon për Krishtin (Gjoni 15:26). Ai na ndërgjegjëson ne për mëkat (Gjonit 16:7-11). Ai na ndihmon të jetojmë jetë të shenjta (Romakëve 15:16). Ai na jep dashuri, gjësim, paqe, durim, mirëdashje, mirësi, zemërbutësi dhe vetëkontroll (Galatasve 5:22-23). Ai na ndihmon t'u tregojmë të tjerëve për besimin tonë (Veprat 1:8) dhe

Ai jeton brenda nesh (Romakëve 8:11).

Këto gjëra janë vetëm fillimi.

Ne nuk mund ta "përkufizojmë" plotësisht Perëndinë Trini, por kjo është pjesa më e mrekullueshme për Zotin. Ai është kaq i mahnitshëm, i plofuqishëm dhe i pashpjegueshëm saqë ne nuk mund ta përkufizojmë atë. As nuk do të donim ta bënim. Ai na bën ta shohim me mahnitje dhe draujtje.

Bibla është e qartë kur thotë që Perëndia është tre në një: Perëndia Atë, Perëndia Bir dhe Perëndia Shpirt i Shenjtë (shih Mateu 28:18-20).

Të treja pjesët janë personalitetë të ndara. Dhe sërisht, së bashku ata formojnë një qenie: Perëndinë.


Në vend që me mendjet tonë të kufizuara njerëzore të përpinqemi të përshkruajmë plotësisht Trininë, ne duhet të fokusohemi në madhështinë e Perëndisë dhe natyrën e Tij pafundësisht të lartë. "O thellësi pasurie, urtësie dhe diturie të Perëndisë! Sa të pahulumtueshme janë gjykimet e tij dhe të pashtershme janë udhët e tij! Sepse kush e njohu mendjen e Zotit? Ose kush u bë këshilltar i tij?" (Romakëve 11:33-34).

Nga Kathryn Church

A photograph of a sunset over a calm lake. The sky is filled with warm orange and yellow hues, transitioning into a darker blue at the top. Silhouettes of trees and hills are visible against the bright sky. In the foreground, the dark silhouette of tall grasses is on the left, and a small, dark boat with a red stripe is on the right, angled towards the center. The water reflects the warm colors of the sunset.

Lum ata që e vënë forcën
e tyre te Ti dhe kanë në
zemër rrugët e Tua!

Psalmeve 84:5



Një pikturë e famshme e paraqet
Jezusin në një kopësht të errët.

Në dorën e majtë mban një llambë
e cila ndriçon vendin, ndërsa me
dorën e djathtë troket në një derë
të fortë e të rëndë.

Kur u paraqit kjo pikturë për herë të
parë në ekspozitë, një vizitues i bëri
piktorit një vërejtje duke u ndalur te
një veçori shumë kureshtare.


“Në pikturën tuaj keni bërë një
gabim. Dera është pa dorezë”.

“Nuk është gabim”, u përgjigj
piktori! “Kjo është dera e zemrës së
njeriut. Mund të hapet vetëm nga
brenda.”



MOS KI *Hriķe*
SEPSE UNĒ JAM ME TY.

- Isaia 41:10



“*Falja* është të hapësh derën për
të lënë dikë të lirë dhe të kuptosh
pastaj që i burgosuri ishe ti!”

MAX LUCADO